




MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NË MES TË:

KOMUNËS SË VUSHTRRISË

DHE

ORGANIZATËS GERMIN

Bazuar në Rregulloren Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik to OJQ-ve Nr. – 04/2017, Neni 2, pika 5.2,

Komuna e Vushtrrisë- Rruga "Isa Boletini", nr.10, 42000 Vushtrri, Kosovë përfaqësuar nga z. Xhafer Tahiri, në tekstin e mëtutjeshëm, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë; dhe

Organizata Jo-Qeveritare GERMIN - Rruga "Tringë Smajli" Nr. 48, 10000 Prishtinë, përfaqësuar nga znj. Liza Gashi, në tekstin e mëtutjeshëm, Drejtoreshë Ekzekutive, në Prishtinë, më poshtë të referuara si "Palët", me vullnetin e lirë, pajtohen që në bashkëpunim të organizojnë projektin "Forumi i Bashkë-Investimeve dhe Rrjetëzmit"- 1';



Duke konsideruar interesin e dyanshëm që në kuadër të funksioneve dhe mundësive ligjore, palët synojnë që përmes këtij bashkëpunimi të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit;

Palët kanë për qëllim që nëpërmjet një bashkëpunimi të tillë të ndihmojnë në realizimin e përgjegjësisë të tyre respektive dhe të nxisin rritjen e të ardhurave dhe investimeve në Komunën e Vushtrrisë;

Palët dëshirojnë që nëpërmjet zbatimit të projektit “Forumi i Bashkë-Investimeve dhe Rrjetëzimit - I” të nxisin angazhimin e diasporës në nivelin lokal, respektivisht në Komunën e Vushtrrisë.

Prandaj, palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Palët në marrëveshje pajtohen për një bashkëpunim pesë (5) mujor në organizimin dhe mbarëvajtjen e Forumit të Bashkë-Investimeve dhe Rrjetëzimit, projekt i cili do të zbatohet përmes këtyre aktiviteteve kryesore:
 - a. Identifikimi dhe hulumtimi i njërit ose disa prej sektorëve me potencial më të madh zhvillimor në Komunën e Vushtrrisë;
 - b. Hartimi dhe publikimi i raportit me të gjeturat kryesore nga hulumtimi;
 - c. Zhvillimi, brendimi dhe promovimi i platformës “Invest in Vushtri”, e qasshme për bizneset dhe grupet e interesit brenda dhe jashtë vendit; Platforma synon të paraqesë potencialin dhe projektet zhvillimore të Vushtrrisë.
2. Palët pajtohen edhe për Aktivitetet specifike të përshkruara në Propozim-Projektin, Planin e Punës dhe Buxhetin, të cilat dokumente janë të bashkangjitura si Aneks-Marrëveshje.

Neni 2

Përgjegjësitë e palëve

1. Palët në marrëveshje, pajtohen që të përmbushin përgjegjësitë e tyre përkatëse në pajtim me dispozitat e këtij memorandum.



2. Palët do ta informojnë njëra-tjetrën për të gjitha aktivitetet me këtë marrëveshje dhe do të kenë konsultime sa herë që njëra palë e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme.
3. Të mbajnë dhe ruajnë bashkëpunimin i cili respekton pavarësinë profesionale dhe transparencën e veprimeve konform kësaj marrëveshje.

Neni 3

Buxheti dhe Obligimet e Palëve

1. Kostoja totale e projektit është **€19,810.00** Euro.
2. Obligimet dhe përgjegjësitë specifike për Komunën e Vushtrrisë:
 - a. Komuna e Vushtrrisë do të mbulojë financiarisht një pjesë të kostos së projektit, në vlerë prej **€9,700.00** Euro. Kjo vlerë do të jipet sipas planifikimit buxhetor me kodin 43900;
 - b. Komuna e Vushtrrisë do të mbështesë dhe përkrah Organizatën GERMIN për gjetje të fondeve nga donatorët potencial për pjesën tjetër të kostos së projektit.
 - c. Komuna ofron hapësirat dhe kapacitetet e saj logjistike nëse është e nevojshme për qëllimet e projektit; Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural bashkëpunon me OJQ Germin në planifikim dhe bashkërendim të aktiviteteve.
 - d. Kryen detyrat e veta specifike të përshkruara në Projekt.
2. Obligimet dhe përgjegjësitë specifike për Organizatën Germin:
 - a. Organizon dhe realizon, në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë, të gjitha aktivitetet e Projektit të përshkruara në Nenin 1 dhe është bartëse e të gjitha procedurave administrative për implementimin e këtij projekti;
 - b. Përdor të gjitha kapacitetet dhe resurset e saj në shërbim të arritjes së objektivave të Projektit;
 - c. Publikon të gjeturat dhe promovon mundësitë e Komunës së Vushtrrisë në fushat prioritare të projektit;
 - d. Bashkëpunon ngushtë me Komunën dhe institucionet tjera me qëllim të zbatimit sa më të suksesshëm të obligimeve dhe aktivitetetve nga Projekti “Forumi i Bashkë-Investimeve dhe Rrjetëzimit - Pjesa e Parë”;



- e. Raporton në vazhdimësi për ecurinë e punëve të projektit dhe në përfundim projektit bën dorëzimin e raportit financiar dhe narrativ, në drejtorinë përkatëse;
3. Palët në marrëveshje, do të kenë përgjegjësi të plotë gjatë përgatitjes dhe konkretizimit të aktiviteteve nga fusha e bashkëpunimit.

Neni 4

Koordinimi

1. Palët koordinohen dhe komunikojnë mes vete përmes personave kontaktues:

Komuna e Vushtrrisë: Personi kontaktues nga Komuna e Vushtrrisë do të jetë Znj. Ragbete Krasniqi - Melenica.

Germin: Personi kontaktues nga OJQ Germin do të jetë znj. Sihana Bejtullahu

Neni 5

Monitorimi dhe Vlerësimi

1. Palët në marrëveshje do të zhvillojnë konsulta të rregullta për të monitoruar dhe rishikuar progresin e aktiviteteve të projektit për të cilat janë pajtuar me këtë marrëveshje.
2. Palët do të ndajnë të gjitha informatat dhe dokumentet përkatëse, përfshirë hulumtimet dhe raportet si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me aktivitetet e projektit.
3. Germin do të bëjë vlerësimin projektit dhe do të ndajë raportin final me Komunën e Vushtrrisë.

Neni 6

Mosmarrëveshjet dhe Ndryshimet

Në rast të mosmarrëveshjeve apo ndryshimeve në Projekt, palët njoftojnë njëra-tjetrën dhe konsultohen për të arritur pajtueshmëri të plotë për zgjidhjen e tyre.

Neni 7

Ndërprerja

1. Secila palë ka të drejtë të shkëputet nga kjo marrëveshje pas konsultimit paraprak të përbashkët dhe njoftimit paraprak me shkrim në afat prej të paktën tridhjetë (30) ditësh.



Neni 8

Validiteti dhe Kohëzgjatja

1. Marrëveshja fillon të zbatohet pasi të ketë marrë aprovimin nga Asambleja Komunale e Komunës së Vushtrrisë.
2. Ky projekt synon të përfundoj në periudhën pesë (5) mujore të vitit 2020.

KOMUNA E VUSHTRRIË



Z. Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës

Më 19 dhjetor 2019, Vushtrri

OJQ GERMIN



Znj. Liza Gashi, Drejtoreshë Ekzekutive

Më 19 dhjetor 2019, Vushtrri